

## INFORMACION

mbi aktivitetin

### **“Prodhim i kepuceve” te shoqerise “ProDyn Albania” Sh.p.k**

Aktiviteti, qe kryen shoqeria “ProDyn Albania” Sh.p.k ne kete objekt, eshte *Prodhim kepucesh*, duke prodhuar suprina kepucesh (pjesa e siperme e kepuces), veshje te kembes (kepuce), si dhe kepuce te perfunduara.

Pra eshte nje ndermarrje fason qe prodhon me material te porositesit, ku ka kontrata me firma gjermane dhe hungareze, te cilat dergojne lenden e pare.

Ndermarrja eshte te godina e ish-supermarketit Praktiker dhe ndodhet ne rrugen Gjergj Balshaj, ne Koder-Kamez, Njesia Administrative Nr-11, bashkia Tirane, ne jug te lumit te Tiranes dhe ne veri te rruges nacionale dhe ures se Koder-Kamez.

Objekti eshte ne pronesi te shoqerise **Prespa Invest sh.p.k** dhe i eshte dhene nje pjese e pasurise ne perdorim me siperfaqe te mbuluar 2575m<sup>2</sup> per aktivitetin privat shoqerise **ProDyn Albania sh.p.k** per periudhen nga 01.10.2016 deri me 31.09.2019, te leshuar me nje **Kontrate Noteriale** nr.4342 Rep., nr.2031 Kol., date 08.06.2016, me noter Gjergj Kongoli.

Shoqeria **ProDyn Albania sh.p.k** ka marre ne perdorim vetem nje pjese te objektit, e cila paraqitet me ngjyre te kuqe ne planvendosjen e objektit. Siperfaqja e kesaj pjese pasurie ne perdorim eshte 2575 m<sup>2</sup>.

Kufizimet e objektit jane:

- Veri me prone private
- Lindje me lumin e Tiranes
- Jug me rrugen nacionale
- Perendim me prona private

Planvendosja e objektit, si dhe kufizimet e pjeses ne perdorim nga shoqeria **ProDyn Albania sh.p.k**, jepen si me poshte:



Fig.1. Planvendosja e objektit

Koordinatat e pjeses ne perdorim nga shoqeria ProDyn Albania sh.p.k, sipas sistemit GAUS KRUGE, jane:

X1= 4580752; Y1= 4397336;

X2= 4580787; Y2= 4397380;

X3= 4580810; Y3= 4397362;

X4= 4580774; Y4= 4397318;

Fabrika perbehet nga:

- **Magazina**, e cila sherben per magazinimin e lendes se pare, si dhe te produkteve si kepuce, suprina, etj.

- **Prestaria dhe Premonta**, qe sherbejne per prerjen e lekures dhe vendosjen e pjeses se poshtme, ku perbehen nga keto makineri dhe paisje:
  - *Tranxha*
  - *Makina per hollimin e lekures (scarnitrice)*
  - *Makina e premontes (Batistira) per vendosjen e pjeses se poshtme te kepuceve.*
- **Reparti i qepjes**, qe sherben per qepjen e suprinave te kepuceve dhe veshjeve te kembes, ku jane vendosur makinat qepese.
- **Linja e prodhimit**, ku nepermjet konvenirit materialet levizin nga njera ne tjetren pajisje, duke u qepur dhe ngjitur me radhe deri ne produkte te perfunduara , si suprina dhe kepuce, ku perbehen nga keto makineri dhe paisje:
  - *Makinat e hekurosjes*
  - *Makinerite e premontimit*
  - *Makinerite e vendosjes se etiketave,*
  - *Makinerite e hapjes se vrimave*
- **Zyrat e mjediset sanitare**
- **Mjediset perreth** (*Vendparkimet, rruget e brendshme, gjelberimi, etj.*)

Fabrika dhe zyrat ndodhen ne nje pjese te objektit (ish-supermarketi Praktiker), qe shoqeria ProDyn Albania sh.p.k ka marre ne perdorim per te ushtruar aktivitetin e saj. Siperfaqja ne perdorim e kesaj pjese pasurie (1-kat) eshte 2575 m<sup>2</sup>, e cila paraqitet me ngjyre te verdhe ne planimetrine bashkelidhur

Kapaciteti prodhues ne kete ndermarrje te fasonerise eshte mesatarisht 25000 pale kepuce dhe 1500 suprina (pjesa e siperme e kepuces) ne muaj.

Numri i makinerive dhe pajisjeve per prodhimin e produkteteve te sipercituara ne kete ndermarrje eshte 123 cope.

Ketu punojne 249 punonjes me kohe te plote me nje turn (14 administrate + 235 puntore). Regjimi i punes ne fabrike eshte nga e hena ne te preme 8 ore pune ne dite, ndersa te shtunen 5 ore pune, me nje turn.

Si lende e pare perdoret lekura, astari, filli dhe mastici.


Materiale ndihmese, qe sherbejne ne prodhim jane aksesoret si etiketa, rrate per kalimin e lidheseve, lidhese, etj.

Per prodhimin e nje pale kepuce konsumohet mesatarisht  $0.06 \text{ m}^2$  lekure,  $0.07 \text{ m}^2$  astar 40ml fill, ndersa per prodhimin mujor prej 25000 pale kepuce konsumohen rreth  $1500 \text{ m}^2$  lekure,  $1750 \text{ m}^2$  astar, 1000000 ml fill dhe 0.5 ton mastic ne muaj.

**Konsumi i masticit ne kete ndermarje eshte rreth 6 ton ne vit.**

Gjithashtu lende ndihmese eshte energjia elektrike, e cila merret nga rrjeti elektrik i ofruar nga OSHEE. Konsumi mujor i energjise elektrike eshte rreth 20 000 Kw.

Procesi i prodhimit kalon neper proceset e pasqyruara ne skemen me poshteme:



*Fig.2. Skema ilustruese e procesit*

Procesi i prerjes se lekures behet nepermjet tranxhave, ndersa hollimi i lekures behet nepermjet skarnitrices.

Procesi i qepjes behet ne reartin e qepjes nepermjet makinave te qepjes , nga ku procesi kalon ne linjen e prodhimit dhe nepermjet konvenierit materialet levizin nga njera ne tjetren pajisje, duke u qepur dhe ngjitur me radhe deri ne produkte te perfunduara , si suprina dhe kepuce.

Me poshte jepen foto te ndryshme te ambienteve dhe te procesit te prodhimit ne ndermarrjen e fasonerise te prodhimit te kepuceve.



**Fig.3.** Foto te ambienteve dhe te procesit te prodhimit

Ne forme te permbledhur kapacitetet e ndermarrjes se fasonerise te prodhimit te kepuceve, te shoqerise **ProDyn Albania sh.p.k**, jane si me poshte:

- Prodhim te 25000 pale kepuce dhe 1500 suprina ne muaj.
- Per prodhimin e nje pale kepuce konsumohet mesatarisht 0.06 m<sup>2</sup> lekure, 0.07 m<sup>2</sup> astar, 40ml fill.
- Numri i makinerive dhe pajisjeve per prodhim eshte 123 cope.
- Konsumi i masticit eshte rreth 6 ton ne vit.
- Fuqi e instaluar 120 kw/h
- Numri total i te punesuaresve eshte 249 punonjes (14 administrate+ 235 puntore).

Mbrojtja ne pune dhe ruajtja e shendetit te punonjesve do te realizohet duke zbatuar me rigorozitet :

- Rregulloren e sigurimit teknik
- Normativat e ndtotesve ne mjediset e punes te miratuara

## **VLERESIMI I NDIKIMEVE**

### ***Ndryshimet ne popullsi***

Aktiviteti nuk ka ndikime ne levizjen apo zhvendosjen e popullsisë se rajonit, madje nga ky investim kemi nje punesim te rreth 249 vetave banore te kesaj zone.

### ***Nivelet dhe ndikimet e emetimeve te ardhura nga aktiviteti***

Gjate prodhimit nuk do te kete emetime te gazrave, lengjeve dhe mbetje te rrezikshme apo substance te tjera te demshme shoqeruese te ketyre shkarkimeve jashte objektit ne natyre, duke mos patur ndikime negative, si tek njerzit, ashtu dhe ne floren e faunen perreth.

*Gjate procesit te ngjitjes duhet kujdes ne evitimin e rrjedhjeve te masticit dhe marrjen e masave per ti grumbulluar ato dhe per ti derguar me tej ne nje vend te posacem, te miratuar nga institucionet e duhura.*

### ***Nivelet dhe ndikimet e zhurmave nga aktiviteti zhvillues***

Niveli i zhurmave që krijohen gjatë veprimtarisë, janë brenda objektit, në nivele të ulëta dhe brenda normave të lejuara, dhe për pasojë nuk kanë ndikim në popullatën përreth. Gjithsesi punonjësit e makinerive duhet të punojnë me masa mbrojtëse (tapa) gjatë procesit të punës.

### ***Ndikimet e aktivitetit të zhvillimit në rruget lokale dhe transportin***

Gjatë aktivitetit nuk do ketë ndryshime të rrjetit të rrugëve lokale dhe transportit. Për rrjedhojë aktiviteti nuk do ndikojë absolutisht në rruget lokale dhe transport.

### ***Ndikimet e aktivitetit të zhvillimit mbi ndertimet, trashëgiminë arkitektonike dhe historike***

Aktiviteti, që ushtron firma **ProDyn Albania sh.p.k.**, zbatohet në një zonë, në sipërfaqen e së cilës dhe në nëntokën e saj nuk ka ndertime lidhur me trashëgiminë arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe mbi vepra të tjera njerezore.

### ***Ndikimet në floren dhe faunen***

Projekti është zbatuar në një lagje të qytetit të Tiranës, prandaj nuk ka ndikime në humbjen apo demtimin e habitateve, specieve bimë dhe shtazore.

### ***Ndikimet në toke***

Si gjatë ndertimit, ashtu edhe gjatë veprimtarisë së objektit nuk do të ketë ndryshime topografike lokale.

### ***Ndikimet në ujera***

Keto procese teknologjike nuk shoqërohen me shkarkime të lëngjave të rrezikshme. Në rrjetin e kanalizimeve do të shkarkohen vetëm ujërat e përdorura higjieno-sanitare.

### ***Ndikimet në ajër***

Referuar natyrës së procesit nuk kemi sasi gazrash të shkarkuar në atmosferë.

### ***Ndikimet me natyrë nderkufitare***

Ky aktivitet nuk ka ndikime me natyrë nderkufitare, sepse është në një lagje të qytetit të Tiranës, brenda territorit të vendit të tij.

Megjithese aktiviteti shoqerohet pa ndikime negative ne vlerat natyrore qe lidhen me ekosistemet, zbatimi i masave te mbrojtjes se mjedisit do te jete objekt i vazhdueshem i subjektit.

Per kete qellim, nga ana e shoqerise jane marre keto masa konkrete:

- ***Territorri perreth repartit***

I gjithe territori perreth objektit dhe sheshet e levizjes jane te shtruara dhe te sistemuara. Nga shoqeria jane marre masa edhe per gjelberimin e territorrit perreth duke bere te mundur mbjelljen me peme.



Fig.4. Foto te sheshit perpara objektit

- ***Mbetjet e ngurta***

Mbetje te krijuara nga coprat e lekures dhe astarit, gjate proceseve te prerjes dhe konturimit te kepuceve dhe sandaleve, apo qe gjenerohen nga punetoret, , kane nje vend provizor grumbullimi te ketyre, dhe rast pas rasti ne bashkerendim me strukturat ligjore lokale i evadojne ato ne vendin e miratur per depozitim te caktuar nga Bashkia Tirane.

- ***Emetimet ne ajer***

Referuar natyres se procesit nuk kemi sasi gazrash te shkarkuar ne atmosfere.



- **Zhurmat**

Niveli i zhurmave qe krijohen gjate veprimtarise, jane brenda objektit dhe jane ne nivele te uleta. Gjithsesi punonjesit e makinerive punojne me masa mbrojtese ( tapa).

- **Gaze te tjera dhe aroma sulmuese**

Referuar natyres se procesit nuk kemi sasi gazrash apo aroma sulmuese ne objekt

- **Rastet aksidentale**

Jane masat per parandalimin e tyre, ku mjetet dhe makinerite kontrollohen vazhdimisht per gjendjen teknike te tyre ne menyre qe te mos kemi rrjedhje lubrifikante. Shoqeria siguron se do kete te gjitha pajisjet e nevojshme per riparim, pastrim dhe nderhyrje te menjehershme nese do te kete ndikime negative ne mjedis.

Gjithashtu jane marre masat per nje sistem emergjence, duke zbatuar me rigorozitet projektin e mbrojtjes kunder zjarrit.

Sipas normave te mbrojtjes nga zjarri, veprimtaria ne objekt perfshihet ne nivelin e ulet te rezikut per zjarr dhe eksplozion ( Raporti teknik per mbrojtjen nga zjarri) dhe eshte e kategorise 3, me norme te rritjes se zjarrit "E shpejte", per shkak te materialit ne reparat.

Per kete, brenda ne objekt dhe ne zonen e zyrave, krahas sistemit te shuarjes me sprinkler dhe hidrante, jane vendosur edhe fikset portative me pluhur, duke respektuar rregullat teknike per mbrojtjen nga zjarri.

Gjithashtu jane marre masat e duhura per evakuimin e personave ne rast te nje emergjence te mundshme.




Fig.5. Foto te sistemit te mbrojtjes kunder zjarrit

#### ▪ **Kushtet e punes**

Per nje pune sa me optimale, ne impiant zbatohen rregullat e sigurimit teknik, ku puntoret njihen me keto rregulla ne menyre periodike.

Jane marre masat e nevojshme per hartimin dhe zbatimin me rigorozitet te planit te perballimit te emergjencave te veprimtarise.

Megjithese gjate aktivitetit ndikimi negativ ne mjedis eshte minimal, per te rritur sigurine ne pune dhe per te ulur ne maksimum impaktin negative ne mjedis, duhet qe:

- Te kryhet rehabilitimi i mjedisit ne rastet e ndonje aksidenti.
- Te kryhet rregullisht kontrolli gjendjes teknike te agregateve dhe makinerive te punes.

#### **Vleresimi i efektivitetit te pritshem te masave zbutese**

Realizimi i objektivave dhe treguesve te pritshem te parashikuar do te varet nga respektimi i te gjitha treguesve te percaktuar. Kontrolli, monitorimi dhe permiresimi i vazhdueshem i kushteve te punes do te cojne perfundimisht ne nje proces pune te kontrolluar, duke mos sjelle pasoja per shendetin e njerzve dhe mjedisin perreth.

Zbatimi korrekt i ketyre masave ben te arrije ne:

- Krijim te nje zone pune optimale per veprimtari te kesaj natyre.
- Evitim te ndotjeve.
- Ambiente optimale higjeno-sanitare
- Permisim te siperfaqes se gjelbert ne objekt e rreth tij.

▪ **Programi i monitorimit**

Nga shoqeria do te monitorohen elementet me ndikim ne mjedis. Te dhenat cilesore, sipas tabelës hidhen ne nje regjister, qe administrohet nga vet kompania dhe relatohet, sipas kushteve te percaktuara ne lejen mjedisore.


Shoqeria kujdeset per administrimin e cdo informacioni, qe lidhet me ushtimin e veprimtarise. Administrimi i te dhenave konsiderohet shume i rendesishem, per menyren e operimit te Shoqerise dhe do te perdoret per te permiresuar eficencen e cdo mase te parashikuar, per zbutjen e ndikimeve ne mjedis dhe ne teresi e monitorimit mjedisor te veprimtarise.

Nr	Elemnti i monitoruar	Frekuenca	Shpjegime
1	Monitorim i gjendjes se mekanikes se proceseve	Vazhdueshem	Nga drejtuesi teknik
2	Monitorimi I te gjithë masave te parashikuara per zbutjen e ndikimeve / Zbatimi i kushteve te lejes se mjedisit	Periodik	Behet analize dhe shqyrtim i efektivitetit te masave te marra hap pas hapi

**STUDIO JON Sh.p.k.**

**EKSPERT & VLERESUES MJEDISI**

**ING. IDHIR GUMBARDHI**



REPUBLIKA E SHqipërisë  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT  
EKONOMIK, TURIZMIT,  
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

LN-1022-02-2016

NUIS/NIPT: L61313056P

Subjekti: STUDIO JON

Adresa: Tirane, TIRANE, Tirane, TIRANE, Njësia Nr. 2, Rruga George. W. Bush,  
Pallati Kasmi, Kati 1, Zyra Nr-105

Kodi: III.2.A (1+2)

Kod tjetër:

Data e lëshimit: 17/02/2016

Afati i vlefshmërisë: Pa afat

Kategoria

Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis

Nënkategoria

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis

Veprimtari specifike

1. Ndikim në mjedis
2. Auditim mjedisor

Specialiteti

# LICENCË

**OKL**  
QENDRA KOMBËTARE E LICENCIMIT  
NATIONAL LICENSING CENTER

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis (Vlerësim i ndikimit në mjedis,  
Auditim mjedisor)

Kufizime specifike


Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

Detyrime specifike

Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë



Nënskrimi i sportelit: PETRA TOMORI